

# AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

## PROGRAMI

**I. Titulli i Programit:** *Kualifikim Profesional për vlerësues dëmsh në sigurime*

**II. Kategoria e Programit:**

x kualifikim profesional                      edukim në vazhdim

**III. Objektivat e Programit:**

- njohja e kuadrit ligjor të aktivitetit të vlerësuesit të dëmeve në sigurime;
- të përvetësojnë parimet themelore të sigurimit: të vlerësimit të dëmeve dhe të mbrojtjes ndaj rrezikut në sigurime, pjesëmarrësit në procesin e sigurimit, klasat në sigurime, specifikat e kategorive kryesore të produkteve të sigurimit, tregu i sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve etj, duke kërkuar që pjesëmarrësit të bashkëveprojnë me materialet e trajnimit dhe të aplikojnë parimet më të mira të vlerësimit të dëmeve në sigurime dhe praktikatat rregulluese;
- kuptimi i parimeve themelore të etikës në biznes, raportimi i dëmit dhe procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

**IV. Grupet e synuara:**

- individët që duan të ndjekin një karrierë profesionale në vlerësimin e dëmeve në sigurime.

**V. Kushtet:**

- arsim i lartë i vërtetuar me diplomë universitare.

**VI. Përmbajtja e Programit:**

**Moduli: Kuadri ligjor & mbikëqyrja e veprimtarisë të vlerësuesit të dëmeve në sigurime**

- Legjislacioni i zbatueshëm për vlerësimin e dëmeve nga vlerësuesit;
- Prezantim me Ligjin 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe bazën rregullatore në zbatim të tij;
- Prezantim me Ligjin 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe bazën rregullatore në zbatim të tij;
- Licencimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë, si vlerësues dëmsh në sigurime;
- Masat administrative ndaj vlerësuesit të dëmeve;
- Problematikat e konstatuara nga shqyrtimi i akteve të vlerësimit;
- Procedurat dhe afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim;
- Kontrata e sigurimit të pasagjerëve dhe mbulimi i saj;
- Përgjegjësia e shoqërisë së sigurimit (shuma e siguruar), përjashtimi nga mbulimi si dhe humbja e së drejtës së mbulimit në sigurim;
- Raporti Evropian i Aksidenteve;
- Qendra e informacionit dhe rëndësia e saj në sistemin e trajtimit të dëmeve;
- Byroja Shqiptare e Sigurimit;
- Fondi i kompensimit;

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

- Trajtimi dhe pagesa e dëmeve që shkaktohen nga mjetet e pasiguruara / paidentifikuara.
- Ilustrim me shembuj

### **Moduli - Tregu i sigurimeve dhe kushtet e kontratave**

- Llojet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit;
- Kushtet dhe elementet ligjore të kontratës së sigurimit;
- Karakteristikat dhe tipet e kontratave të sigurimit, marrja në sigurim të përgjegjësive;
- Vështrim mbi nocionet e dëmeve të parashikuara në ligjin e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë ndaj palëve të treta;
- Roli i vlerësuesve të dëmeve në sigurime;
- Llojet e sigurimit të detyrueshëm të parashikuara në ligjin e sigurimeve dhe risigurimeve dhe trajtimi i dëmeve sipas tyre (sigurimi i pasagjerëve, sigurimi i anijeve, avionëve);
- Procedurat e trajtimit të dëmeve si: parapagesat e dëmshpërblimit, trajtime të vecanta të dëmeve, procedurat e subrogimit, procedurat e arbitrazhit dhe ndërmjetësimit;
- Vlerësimi i dëmeve jopasurore sipas ligjit;
- Vendimi gjyqësor penal dhe ndikimi i tij në vlerësimin e dëmeve gjatë gjykimit civil;
- Bashkëpërgjegjësia e pjesëmarrësve në aksident gjatë vlerësimit të dëmeve në gjykimin civil;
- Ilustrim me shembuj.

### **Moduli - Trajnimi, kompetencat dhe kualifikimet e vlerësuesve të dëmeve në sigurime**

- Rëndësia e trajnimit, kompetencat dhe kualifikimet e vlerësuesve të dëmeve në sigurime;
- Prezantimi me Rregulloren nr. 198, datë 29.12.2020 “Për kualifikimin profesional dhe edukimin në vazhdim”.
- Vlerësimi i trajnimit nga Autoriteti;
- Regjistrimi i profesionistëve për njohjen e krediteve;
- Ofruesit e aktiviteteve për edukim në vazhdim dhe kualifikim profesional;
- Njohja nga Autoriteti e programit të aktiviteteve të kualifikimit profesional dhe edukimit në vazhdim si dhe procesi i monitorimit.
- Ilustrim me shembuj.

**VII. Kohëzgjatja e Programit:** 8 orë